

Skender LUTFIU

ÇËSHTJA E PËRCAKTIMIT TË KUFIRIT VERILINDOR TË SHQIPËRISË SIPAS RAPORTEVE TË KONSUJVE AUSTRO-HUNGAREZË

Abstrakt

Ndonëse u shkëput nga Perandoria Osmane më 1912, Shqipëria ende e kishte të pazgjidhur çështjen e përcaktimit të kufirit verilindor dhe atij jugor. Në këto rrethana, problemet me vendet fqinje në vitet pasuese ishin evidente, prandaj ishte e nevojshme mbikëqyrja ndërkombëtare. Fuqitë e Mëdha ishin të përfshira intensivisht në zgjidhjen e përcaktimit të kufijve të Shqipërisë, jo vetëm në mbledhjet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, por edhe nëpërmjet komisionit ndërkombëtar të kufijve, i cili po ashtu kishte marrë mandatin nga këto vende. Nga të gjitha fuqitë e kohës, Austro-Hungaria ishte më e përfshira në këtë çështje, për faktet tashmë të njohura.

Si rezultat, kori diplomatik i akredituar në qytetet shqiptare brenda dhe jashtë Shqipërisë politike dhe qendrat e tjera, gjatë viteve 1913 dhe 1914 në baza ditore ka mbajtur të informuar Vjenën zyrtare për gjithë ecurinë e punës së komisionit ndërkombëtar rreth zgjidhjes së çështjes së përcaktimit të kufirit verilindor të Shqipërisë. Prandaj, në raportet e tyre, pashmangshëm kjo çështje ishte ndër temat më të shtjelluara, ngase qëllimi i konsujve ishte informimi i Ministrisë së Jashtme në Vjenë në kohë reale dhe sa më i saktë. Edhe Leopold Berhtold-i, dhe në përgjithësi Ministria e Jashtme ishte e angazhuar në zgjidhjen e çështjes së demarkimit të kufirit verilindor të Shqipërisë. Prandaj, konsujve austro-hungarezë në qendrat shqiptare dhe në kryeqendrat evropiane u jepte instruksione për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Në raportet e shkëmbyera ndërmjet konsujve austro-hungarezë me Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë dhe anasjelltas, pasqyrohen në detaje të gjitha etapat e punës së Komisionit Ndërkombëtar të Kufirit, duke filluar me emërimin dhe

shkarkimin e anëtarëve të këtij komisioni, punën e kryer dhe vështirësitë që kanë hasur në terren, etj. Nëpërmjet trajtimit të këtyre raporteve është pasqyruar qëndrimi i diplomacisë austro-hungareze në lidhje me demarkimin e kufijve të Shqipërisë, në veçanti të atij verilindor.

Fjalë kyçe: *Shqipëria, Austro-Hungaria, Komisioni Ndërkombëtar, kufijtë, konsujt etj.*

Telegramet, raportet dhe shkresat zyrtare të konsujve austro-hungarezë drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë

Në vitet 1913-1914 Perandoria Austro-Hungareze vijoi përkushtimin e saj zyrtar për konsolidimin e shtetit shqiptar, i cili, ndër të tjera, falë mbështetjes së Vjenës zyrtare ishte shpallur më 28 nëntor 1912, ndërsa ishte njohur ndërkombëtarisht më 29 korrik 1913. Prandaj, konsujt austro-hungarezë që ishin të akredituar në qendrat më të mëdha të Shqipërisë politike dhe në qendrat e tjera shqiptare jashtë kufijve të saj, në baza ditore informonin Vjenën për çdo zhvillim në të gjitha fushat. Meqë çështja e përcaktimit të kufijve të Shqipërisë mbeti ende e pazgjidhur¹, Fuqitë e Mëdha e formuan një Komision

¹ Që në takimin e parë të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (17 dhjetor 1912) u përvijuan në parim kufijtë e Shqipërisë, ku u vendos që ajo të kufizohet me Malin e Zi në veri dhe me Greqinë në jug, duke lënë mundësinë e ndryshimit të tyre. Mbi bazën e këtij vendimi, Serbisë iu mohua dalja e saj në Adriatik nëpërmjet Shqipërisë Veriore, por ajo do të lidhej me detin Adriatik përmes lidhjeve hekurudhore, me një port neutral, i cili u la i paspecifikuar, pasi austriakët rrëzuan propozimin e ministrit të Jashtëm anglez, Grey, për Shëngjinin. Vendimi për caktimin e portit konkret u vendos të merrej nga një komision që do të krijohet më vonë nga Fuqitë e Mëdha. Më 20 dhjetor 1912 përfaqësuesi rus, Bekendorf, dhe ai austro-hungarez Mensdorff, paraqitën propozimet e tyre mbi kufijtë e Shqipërisë, propozime që ndryshonin shumë nga njëri-tjetri. Meqë kishte përplasje të shumta nga Fuqitë e Mëdha, diskutimet për caktimin e kufijve të Shqipërisë nisën në janar 1913, ndërsa më 22 mars u vendos të shkëputej nga Shqipëria, Kosova dhe viset shqiptare në Maqedoninë Perëndimore. Akti i fundit i Konferencës së Ambasadorëve për kufijtë verilindorë të Shqipërisë ishte nënshkrimi i marrëveshjes së Shëngjinit, më 9 maj 1913, kur u hoq rrethimi i Shkodrës dhe kur ky qytet u ribashkua me Shqipërinë. Për më tepër shih në: *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi I, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike-Instituti i Historisë, 2022, 158-161; Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë I*, Tiranë: Toena, 2013, 122-138; Gazmend S. Rizaj, *Shqipëria e sipërme 1800-1913*, Prishtinë: Instituti

Ndërkombëtar të Kufijve. Ky komision trajtoi çështjen e kufirit jugor dhe të atij verilindor.

Kështu, më 9 mars 1913 konsulli Lejhanec i dërgoi një telegram Ministrisë së Jashtme në Vjenë, nëpërmjet të cilës e informon në lidhje me qëndrimin e Ismail Qemalit dhe deklaratën e tij se ndjehet i gëzuar që merr vesh për vendimin për bashkimin e Shkodrës dhe të Janinës me Shqipërinë.² Mirëpo, Janina siç shihet nga vendimet e mëtejshme mbeti jashtë kufijve të Shqipërisë. Në fakt, për zgjidhjen e çështjes së kufijve verilindorë të Shqipërisë, është marrë vendim nga Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 22 mars 1913, mirëpo për zbatimin e këtij vendimi nga këto vende është formuar Komisioni Ndërkombëtar i përcaktimit të kufijve të Shqipërisë Veriore, i cili përgjatë viteve 1913-1914 ka bërë përpjekje për zgjidhjen definitive të problemit të demarkacionit me vendet fqinje.

Krahas, problemit me kufijtë jugorë dhe juglindorë, zgjidhja e problemit të kufirit verilindor ishte ndër problemet më të vështira, që jo pak sfidoi, jo vetëm diplomacinë e shtetit shqiptar, por edhe Komisionin Ndërkombëtar të Kufijve që ishte në fakt zgjatim i diplomacisë së Fuqive të Mëdha. Vlen të theksohet fakti se Mali i Zi dhe Serbia nuk u bindeshin vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër për përcaktimin e kufijve të Shqipërisë. Andaj, këto dy vende gjatë vitit 1913 nëpërmjet forcave ushtarake sulmuan e para Shkodrën gjatë marsit, ndërsa e dyta Kosovën, Dibrën dhe treva të tjera shqiptare. Të gjitha këto zhvillime dramatike për shtetin e sapoformuar shqiptar janë pasqyruar në raportet e konsujve austro-hungarezë, të cilët në detaje jepnin të dhëna me interes për gjendjen e përgjithshme dhe në veçanti përpjekjet e Komisionit të Kufijve për zgjidhjen në terren të demarkimit të kufirit verilindor të Shqipërisë. Edhe gjatë muajit prill diplomacia austro-hungareze ka bërë përpjekje për zgjidhjen e çështjes së kufirit verilindor të Shqipërisë. Kështu, në një raport të Ministrisë së Luftës, drejtuar Ministrisë së Jashtme në Vjenë, të datës 12 prill 1913, ndër të tjera

Albanologjik, 2011; Arben Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha, 1912-1914*, Tiranë: Toena 2012 etj.

² *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1913)*, Vëllimi I, përgatitja dhe redaktimi për botim nga Marenglen Verli, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2022, 384.

thuhet se punimet për caktimin e kufirit verior dhe verilindor të Shqipërisë duhet që të fillojnë sa më parë, prandaj që tani duhet të nisët për në Shkodër koloneli i Shtabit të Përgjithshëm, Karl Gottliher.

Gjithashtu, Ministria e Luftës i kishte parashtror disa çështje prej 8 pikash, të cilat priste t'i miratoheshin nga Ministria e Jashtme. Pika e parë përcakton bazën për vijën e kufirit që ka për t'u caktuar prej Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve, e që është vendosur pranë Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe vija që është hequr mbi hartën e përgjithshme të Institutit Gjeografiko-Ushtarak në Vjenë, ndërsa pika e dytë trajton çështjen e aprovimit pa rezerva nga Fuqitë e Mëdha të përfaqësuara në komision, dhe njohjen prej tyre të vijës kufitare që është caktuar prej komisionit ndërkombëtar dhe se garantohet respektimi i saj prej shteteve të përfshira në këtë proces: nga Mali i Zi, Serbia dhe Shqipëria. Në pikën e tretë është shtjelluar çështja që një devijim i rëndësishëm prej vijës së kufirit të vendosur prej Konferencës së Ambasadorëve konsiderohet vetëm atëherë si i detyrueshëm, në qoftë se për një veprim të tillë shprehen pesë anëtarë të komisionit në favor. Janë dhënë edhe specifika tejet me rëndësi për mbarëvajtjen e këtij procesi kompleks.³

Është me rëndësi të theksohet telegrami shifër i 19 qershorit 1913 i Ministrisë së Jashtme austro-hungareze në Vjenë, për ambasadorët në Londër, Paris, St. Petersburg, Berlin dhe Romë, për vendimin e mbledhjes së Londrës për caktimin e kolonelit Karl Gottliher anëtar i Komisionit të Caktimit të Kufirit Verior dhe Verilindor të Shqipërisë, i cili së afërmi do të nisët për në Shkodër. Ndërsa, për caktimin e hollësirave të vijës së kufirit Enos dhe Midia majori në korpusin e Shtabit të Përgjithshëm, Moric Fisher Ritteri fon Ledenice. Të nesërmen për këtë vendim Ministria e Jashtme e njofton nëpërmjet një note Ministrinë e Luftës në Vjenë dhe nevojën që të përshpejtohet fillimi i punimeve për caktimin e kufirit në verilindje të

³ Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë (më tej: *AIH*), Fondi. Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë (Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanian), AIH, Vj. 23-14-183, Viti 1913, fl. 206-214. Raport i Ministrisë së Luftës, drejtuar Ministrisë së Jashtme në Vjenë, i datës 12 prill 1913, në lidhje me fillimin e punimeve për caktimin e kufirit verior dhe verilindor të Shqipërisë dhe nisjen për në Shkodër të kolonelit të Shtabit të Përgjithshëm, Karl Gottliher, Vjenë, më 12 prill 1913.

Shqipërisë.⁴ Mirëpo, një muaj më pas, respektivisht më 28 korrik 1913, sipas raporteve diplomatike, Karl Gottliher u zëvendësua nga koloneli August Micel, i cili u emërua anëtar i Komisionit për Caktimin e Kufirit të Shqipërisë së Veriut, duke përfaqësuar kështu Perandorinë Austro-Hungareze.⁵

Sipas një note të Ministrisë së Jashtme në Vjenë, drejtuar Ministrisë së Luftës austro-hungareze më 19 korrik 1913, bazuar në vendimin e mbledhjes së Londrës për caktimin e kufirit të Shqipërisë ndër të tjera thuhej: “Kufiri i Shqipërisë do të fillojë në bregun e Adriatikut te derdhja e Bunës, duke përfshirë Taraboshin pastaj duke përshkuar liqenin afër fshatit Zogaj, që i mbetet Shqipërisë deri tek gjiu i Liqenit të Hotit. Fiset e Grudës dhe të Hotit iu dhanë Malit të Zi, ndërsa fiset e Kastratit dhe Kelmendit mbetën brenda kufijve të Shqipërisë. Kufiri bashkohet midis fisit të Kuqit dhe fisit të Kelmendit deri në territorin e Gucisë dhe Plavës, qytete të cilat bashkë me rrethet e tyre i mbetën Malit të Zi. Më tej kufiri arrin në jug të qytetit të Gjakovës, që lihet jashtë Shqipërisë dhe shtrihet deri te Drini i Bardhë. Kufiri e ndjek rrjedhën e këtij lumi deri në perëndim të Prizrenit dhe pastaj vijën kufitare midis distriktit të Prizrenit e më vonë distriktit të Lumës, duke ia lënë këtë të fundit Shqipërisë. Prej andej kufiri ndjek malin e Korabit, duke ia lënë Shqipërisë distriktin e Dibrës së Poshtme dhe duke lënë jashtë Shqipërisë distriktin e Rekës. Duke u larguar pak në veri të qytetit të Dibrës, që mbetet jashtë Shqipërisë, kufiri arrin te Drini i Zi për të vazhduar deri te vendi ku ndahet pellgu i Drinit nga ai

⁴ AIH, Fondi. Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vj. 23-14-1484, Viti 1913, fl. 222-223. Telegram shifër nga Vjena i Ministrisë së Jashtme austro-hungareze, për ambasadorët në Londër, Paris, St. Petersburg, Berlin dhe Romë, për vendimin e mbledhjes së Londrës për caktimin e kolonelit Karl Gottliher, anëtar i Komisionit të Caktimit të Kufirit verior dhe verilindor të Shqipërisë, Vjenë, më 19 qershor 1913.

⁵ AIH, Fondi. Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vj. 23-12-1207, Nr. 11.826, Viti.1913, fl. 515-517. Notë e Ministrisë së Luftës të Austro-Hungarisë, dërguar kolonelit Micel, anëtar i Komisionit të Caktimit të Kufirit në Shqipërinë e Veriut dhe Ministrisë së Jashtme të Vjenës, në lidhje me ndryshimet në stafin e komisionit dhe trajtimin e anëtarëve të tij, Vjenë, më 28 korrik 1913.

i Shkumbinit dhe duke e lënë Strugën jashtë Shqipërisë, ai arrin në bregun e liqenit të Ohrit në afërsi të fshatit Lin”.⁶

Është me rëndësi të theksohet një protokoll i vendimeve të Komisionit Ndërkombëtar të Përcaktimit të Kufijve të Shqipërisë Veriore, në Vermosh, sipas së cilit nga data 3 deri më 29 korrik është punuar në terren në zgjidhjen e çështjes së kufirit. Madje thuhet se delegatët rusë dhe ata francezë e kanë propozuar tanimë zgjidhjen e tyre në Vermosh, ndërsa delegatët gjermanë, austro-hungarezë dhe italianë, do ta saktësojnë së shpejti zgjidhjen e tyre, por gjithnjë sipas direktivave të marra nga vendimet e Konferencës në Londër.⁷ Bazuar në raportet e korit diplomatik austro-hungarez del që krahas problemeve të tjera, si vendosja e komisionit në Shkodër, problemi me përkthyesit e gjuhëve etj., në mes të delegatëve të Fuqive të Mëdha gjatë zhvillimit të mbledhjeve të Komisionit të Kufijve kishte diskutime dhe mospajtime, të nxitura sipas politikës që ndiqnin kryeqendrat e tyre, të cilat ndikonin në zvarritjen e zgjidhjes së problemit të kufirit.

Edhe gjatë muajit shtator Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve ka bërë përpjekje për përfundimin e punimeve në lidhje me përcaktimin e kufirit verilindor të Shqipërisë. Kështu, më 2 shtator 1913 nga një informacion i Ministrisë së Luftës dërguar inspektorit të ushtrisë në Sarajevë, kuptojmë mbi përgatitjet për Komisionin Ndërkombëtar të Caktimit të Kufirit, ku jepen hollësi rreth vendosjes në Shqipëri dhe të masave përgatitore të Komisionit.⁸ Ndërsa, në një

⁶ AIH, Fondi. Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vj. 23-14.1486, Nr. 3442, Viti.1913, fl.426-429. Notë e Ministrisë së Jashtme Vjenë, drejtuar Ministrisë së Luftës Austro-Hungareze, me të cilën dërgohet teksti i vendimit të mbledhjes së Londrës për caktimin e kufirit të Shqipërisë, i redaktuar, Vjenë, më 19 korrik 1913.

⁷ AIH, Fondi. Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vj. 23-40-3932, Nr. 197, Viti 1913, fl.304-311. Protokoll i veprimeve dhe vendimeve të Komisionit Ndërkombëtar të Përcaktimit të Kufijve të Shqipërisë Veriore, në Vermosh.

⁸ AIH, Fondi. Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vj. 23-9-953, Nr. 11820, Viti.1913, fl.88-90. Informacion i Ministrisë Perandorake dhe Mbretërore të luftës në Vjenë, dërguar inspektorit të ushtrisë në Sarajevë, Korpus Komandës 15 dhe 16, inspektoratit të transportit në Sarajevë dhe depos së materialit të transportit në Klosterneuburg etj., mbi përgatitjet për Komisionin Ndërkombëtar të Caktimit të Kufirit të Shqipërisë Veriore dhe Verilindore, Vjenë, më 2 shtator 1913.

telegram të 26 shtatorit 1913 nga konti Berhtold, drejtuar përfaqësuesit konsullor të Austro-Hungarisë në Romë, kontit Ambrozi, në lidhje me dhënien e instruksioneve, ndër të tjera nga konsujt austro-hungarezë kërkohet të hynë në bisedime me Esat Pashën, për shkak se Kabinetet e Vjenës dhe të Romës ndodhen në një shkëmbim mendimi me qëllim që të respektohen prej Serbisë, vendimet e Londrës, përsa iu përket kufijve dhe neutralitetit të Shqipërisë si dhe lënies së lirë të pazareve të Gjakovës dhe të Dibrës për banorët kufitarë shqiptarë. Këto mendime të të dy kabineteve mund të përkraheshin më mirë prej anës shqiptare duke u demonstruar me mbajtjen e qetësisë kundër pretendimeve të ngritura nga Serbia.⁹ Ndërsa, në një telegram të datës 29 shtator 1913 nga konsulli austro-hungarez, Bilinski, në Manstir, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi caktimin e vijës kufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë si dhe çështjen e Gjakovës dhe Dibrës ndër të tjera shprehet se Rakiqi i kishte thënë se Serbia nuk mund të ekzistojë efektivisht pa këto dy qytete, me qëllim justifikimin e pushtimit të tyre.¹⁰

Është me rëndësi telegrami i datës 8 nëntor 1913 i anëtarit austro-hungarez të Komisionit të Kufirit, koloneli Micël, dërguar konsullit të përgjithshëm, me të cilën e informon mbi ngecjet në vazhdimin e punimeve të këtij komisioni si pasojë e kushteve klimatike dhe kërkesës nga delegati francez që të ndërpriten punimet deri në fillim të vitit 1914.¹¹ Ndërsa, në një telegram nga Berlioni, i

⁹ AIH, Fondi. Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vj. 23-18-1817, Viti 1913, fl. 257-258. Telegram i kontit Berchtold, drejtuar kontit Ambrozi në Romë, në lidhje me qëndrimin e qeverisë së Vjenës dhe të Romës, për të respektuar vendimet e Londrës, në lidhje me kufijtë dhe neutralitetin e Shqipërisë, Vjenë, më 26 shtator 1913.

¹⁰ AIH, Fondi. Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vj. 23-18-1822, Nr. 5160, Viti 1913, fl. 348. Telegram nga konsulli i përgjithshëm austro-hungarez në Manastir, Bilinski, në lidhje me qëndrimin e Rakiqit për çështjen e kufirit shqiptaro-serb dhe justifikimin për pushtimin e Gjakovës dhe Dibrës nga Serbia, Manastir, më 29 shtator 1913.

¹¹ AIH, Fondi. Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vj. 23. 8. 821, Nr. 9, Viti 1913, fl. 101-102. Telegram i anëtarit austro-hungarez të Komisionit të Kufirit, koloneli Micël, dërguar konsullit të përgjithshëm, me të cilën e informon mbi ngecjet në vazhdimin e punimeve të këtij komisioni si pasojë e kushteve klimatike dhe kërkesës nga delegati francez që të ndërpriten punimet deri në fillim të vitit 1914, Jablanicë, më 8 nëntor 1913.

kontit Izogyeng, të datës 22 nëntor 1913 thuhet se është kërkuar që qeveritë në Athinë e Beograd të kujtojnë sërish vendimin e 22 marsit të Konferencës së Londrës mbi përcaktimin e kufirit verilindor të Shqipërisë.¹²

Këtë qëndrim e thekson edhe konsulli austro-hungarez në Paris, Çezhen, i cili në një telegram dërguar kontit Berhtold në Vjenë ndër të tjera thekson se: *“të gjitha kabinetet, dhe në radhë të parë ai i Francës, janë dakord që caktimi i kufirit verior dhe verilindor i Shqipërisë, ka për t’u kryer ekskluzivisht në bazë të vendimeve të Londrës dhe se prania eventuale e trupave malazeze, ose serbe në krahinat që simbas kuptimit të akordeve të Londrës i përkasin Shqipërisë, nuk mund që të ushtrojë asnjë lloj influence mbi punimet dhe vendimet e komisionit ndërkombëtar të caktimit të kufirit”*.¹³ Madje, sipas raporteve të konsujve austro-hungarezë për demarkimin e kufirit me Shqipërinë ishte formuar nga qeveria e Beogradit dhe e Athinës një “komision për caktimin e kufirit serbo-grek”. Për vazhdimin e punimeve të këtij komisioni më 13 nëntor 1913 ka njoftuar nëpërmjet telegramit edhe konsulli austro-hungarez në Manastir, Litkovjzky, sipas të cilit “Komisioni serbo-grek” kishte mbërritur në jug të Pogradecit dhe Starovës, mirëpo kishte pezulluar veprimtarinë e tij si rrjedhim i mbërritjes së Komisionit Kufitar të Shqipërisë së Veriut, ndonëse ishte kthyer për Pogradec, me qëllim që të vazhdojë caktimin e kufirit greko-serb kah perëndimi me territorin shqiptar. Mirëpo, punimet e tij nuk u morën parasysh nga Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve.¹⁴

¹² AIH, Fondi. Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vj. 23-35-3571, Nr. 484, Viti.1913, fl. 305. Telegram i kontit Izogyeng, drejtuar Ministrisë së Jashtme në Vjenë, në lidhje me kërkesën për qeveritë e Athinës dhe Beogradit për të respektuar vendimet e Konferencës së Londrës të 22 marsit mbi përcaktimin e kufirit verilindor të Shqipërisë, Berlin, më 22 nëntor 1913.

¹³ AIH, Fondi. Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vj. 23-9-911, Nr. 100/F, Viti.1913, fl.308-309. Telegram i konsullit austro-hungarez në Paris, Çezhen, dërguar kontit Berhtold në Vjenë, në lidhje me dakordimin e qeverisë franceze që caktimi i kufirit verior dhe verilindor të Shqipërisë të mbështetet në vendimet e Konferencës së Londrës, Paris, më 22 nëntor 1913.

¹⁴ AIH, Fondi. Dokumentet të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vj. 23. 35. 3566, Nr. 116. Viti 1913, fl. 167. Telegram i konsullit austro-hungarez në Manastir, Litkovjzky, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi pezullimin e punës së Komisionit serbo-grek pas arritjes së Komisionit

Edhe në gjysmën e vitit 1914 çështja e përcaktimit të kufirit verior dhe verilindor të Shqipërisë ka qenë ndër temat kryesore që konsujt austro-hungarezë dhe diplomacia austro-hungareze në përgjithësi, kanë trajtuar në telegramet dhe shkresat që kanë shkëmbyer me Ministrinë e Jashtme në Vjenë. Është me rëndësi të përmendet një urdhër i kontit Berhtold, dhënë ministrit Fuqiplotë austro-hungarez në Cetinë, Otto, për të protestuar pranë qeverisë malazeze për gjendjen e krijuar në Vermosh, që mbanë datën 3 janar 1914. Malazezët pretendonin Vermoshin për vete, prandaj në përgjigjen e tyre dhënë të ngarkuarit me punë të Italisë, për çështjen e kufirit kanë deklaruar: “kufirit niset nga lartësia Vila në kufirin e vjetër malazezo-turk, ndjek vijën e kreshtës që korrespondon me ndarjen e ujërave dhe kufirin e vjetër të Sanxhakut dhe shkon në drejtim të jugut përmbi pikat, që në hartën speciale shënohen me Tresoman dhe Grebeni-Selo, kështu që Vermoshi i mbetet Malit të Zi. Prandaj, Otto-ja kërkon nga kontin Berhtold t’i jap konstruksione, i cili në përgjigjen e dhënë shprehet se autorizimi i dhënë atij (Otto-s) mbetet në fuqi dhe madje e urdhëron, që të bëjë demarshin pranë qeverisë mbretërore malazeze sapo të ketë marrë edhe kolegu gjerman instruksionet analoge”.¹⁵

Për çështjen e Vermoshit dhe qëndrimin e Vjenës zyrtare është me rëndësi të shihet edhe telegrami i ambasadorit austro-hungarez në Paris, Szécsen drejtuar kontit Berhtold, i datës 9 janar 1914, me të cilin e informon mbi takimin me ministrin e Francës, Donmerg.

Ndër të tjera Szécsen ka kërkuar nga ministri francez që t’i japin instruksione përkatëse delegatit francez pranë Komisionit Ndërkombëtar për caktimin e kufirit verior të Shqipërisë, me qëllim që ai të marrë në konsideratë pikëpamjen e Vjenës zyrtare konform vendimeve të Londrës. Donmerg-u e informoi ambasadorin austro-hungarez në Paris që, qeveria franceze është për zbatim të përpiktë të vendimeve të Londrës.¹⁶ Pra, nga qëndrimi i Berhtold-it dhënë ministrit fuqiplotë austro-hungarez në Cetinë, Otto-s, dhe qëndrimi i

Ndërkombëtar për Kufirin Verior dhe Verilindor të Shqipërisë, Manastir, më 13 nëntor 1913.

¹⁵ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1914)*, Vëllimi I (janar-shkurt), përgatitja dhe redaktimi për botim nga Luan Malltezi, Eriketa Kambo dhe Marenglen Verli, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2019, 127-128.

¹⁶ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1914)*, 208-209.

ambasadorit Szécsen në Paris, shihet qartë se Vjena zyrtare ishte kundër që Vermoshi t'i mbetej Malit të Zi.

Çështja e padefinuar e kufirit verior dhe verilindor të Shqipërisë ka mbajtur të tensionuar popullsinë shqiptare të këtyre trevave, e cila në jo pak raste ka shprehur indinjatën e saj pranë konsullatave austro-hungareze, duke u shprehur kundër përfshirjes së trevave të tyre nën Malin e Zi. Kështu, më 6 janar 1914 pleqësia e 23 fshatrave të krahinës së Anamalit i drejtoi një lutje përfaqësuesit të konsullatës austro-hungareze në Shkodër, për të mos lejuar shkëputjen e tyre nga Shqipëria dhe përfshirjen e kësaj treve nën Malin e Zi. Në këtë lutje ndër të tjera thuhet: *“mbasi këto 23 katunde banohej pa përjashtim nga shqiptarë dhe prej asnjë malazezi, lutemi që të mos na shkëputni nga atdheu ynë i shtrenjë edhe të mos na cedoni tek Mali i Zi”*.¹⁷

Se çështja e përcaktimit definitiv të kufirit në Shqipërinë e Veriut ishte domosdoshmëri e kohës e dëshmon edhe një relacion i delegatit austro-hungarez pranë Komisionit të Kufirit në Shqipërinë e Veriut, koloneli Micel, dërguar Ministrisë së Jashtme në Vjenë, në të cilën kërkon domosdoshmërinë e ngritjes së shërbimit policor në zonat neutrale të kufirit verior të Shqipërisë sipas gjykimit të vet popullsisë së këtyre zonave. Arsyeja e kësaj kërkesë ishte frika e fshatrave të banuara me popullsi shqiptare (krahina e Topojanit dhe Dolovishtës me 12 fshatra dhe krahinat pranë Dibrës), nga pushtimi i sërishëm prej forcave serbe. Në fakt, shumica e këtyre fshatrave tashmë ishin të djegura dhe të pabanueshme, ndërsa të tjerat pas nisjes së Komisionit të Kufirit, ishin ripushtuar nga serbët.¹⁸ Për situatën e vështirë në kufirin verior të Shqipërisë, ku ndërhynte pala serbe dhe malazeze kuptojmë edhe nga një relacion që nënkonsulli austro-hungarez në Prizren, Kolrus, i dërgon kontit Berhtold, më 23 janar 1914. Këtu jepen detaje sesi forcat serbe dhe malazeze nuk zbatonin vendimet e Konferencës së Londrës, ngase depërtonin në fshatrat shqiptare brenda kufijve të shtetit shqiptar.¹⁹ Komisioni Ndërkombëtar për Përcaktimin e Kufijve Veriorë dhe Verilindorë të Shqipërisë haste në vështirësi të shumta. Njëra ndër to ishte edhe çështja e përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në këtë komision, të cilët gjithsesi që mbanin qëndrimin e

¹⁷ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1914)*, 153-154.

¹⁸ Po aty, 250-251.

¹⁹ Po aty, 374-375.

qendrave prej nga vinin. Shembull, delegatët austro-hungarez, gjerman dhe italian mbanin qëndrim favorizues ndaj Shqipërisë, në dallim nga delegati francez dhe ai rus, që ishin proserbë. Për të mundësuar zgjidhjen më të lehtë të shumë çështjeve kontestuese vlen të përmendet kërkesa e palës angleze, sipas së cilës në veprimtarinë e mëtejshme të Komisionit për Caktimin e Kufijve Veriorë të Shqipërisë, vendimet të merren me shumicë të votave. Kështu, në një relacion që mbanë datën 16 janar 1914, i të ngarkuarit me punë të Austro-Hungarisë në Londër, drejtuar ministrit të Jashtëm, Berhtold, ndër të tjera për këtë çështje thuhej: *“Sipas mendimit të Foreign Office do të ishin pikërisht Austro-Hungaria dhe Italia ato, që nuk do të kishte rrezik se mund të merrej një vendim që nuk do t’u pëlqente atyre, mbasi në të shumtën e rasteve ata mund të llogarisnin votën e delegatit gjerman ose anglez. Në këtë mënyrë, në qoftë se nuk do të realizohej shumica e votave, do të realizohej së paku barazimi i votave”*.²⁰

Gjatë përpjekjeve të Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve, kishte kërkesa nga më të ndryshmet, të cilat janë pasqyruar në raportet e konsujve austro-hungarezë. Një nga këto ishte ajo e argjipeshkvit të Tivarit, i cili kërkonte shkëmbimin e krahinave të Hotit dhe Grudës me Kelmendin. Në një raport të ministrit fuqiplotë austro-hungarez në Cetinë, Otto-s, drejtuar Berhtold-it, që mbanë datën 1 shkurt 1914, për këtë çështje ndër të tjera thuhej: *“Këta [banorët e Hotit dhe Grudës, S.L.] qenkan elementë shumë të paqetë dhe të panënshtrueshëm, të cilët jo vetëm qeverisë por edhe atij [Dobrecismirit, S. L.] do t’i nxirrnin shumë telashe [...]. Por a ishte me të vërtetë e pamundur që këta njerëz të shkëmbehen përkundrejt kelmendasve? Më tej në këtë raport Otto-ja ka pasqyruar qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje: “Kjo dëshirë e Malit të Zi ishte e njohur edhe për mua e ndonëse nuk më kanë ofruar një gjë të tillë [...]. Unë e konsideroj të pamundur, që në akordin mbi kufijtë e Shqipërisë të arritur me aq shumë mundim, të vihej një pykë dhe kështu t’u hapej dera aspiratave analoge të fuqive të tjera”*.²¹ Edhe në raportin e 18 shkurtit 1914 dërguar kontit Berhtold jepen specifika mbi disa opsione lidhur me plotësimin e dëshirës së Malit të Zi për korrigjime në kufirin verior shqiptar.²² Për

²⁰ Po aty, 283-284; 699-700.

²¹ Po aty, 449

²² Po aty, 617.

këtë çështje, më 23 shkurt 1914 Ministria e Punëve të Jashtme, i dërgon një telegram ministrit Fuqiplotë në Cetinë, Otto, ku jepet qëndrimi i rezervuar ndaj autoriteteve të Malit të Zi për çështjen e ratifikimit të kufirit verior të Shqipërisë. Vjena zyrtare ishte kategorikisht kundër dhënies së Taraboshit Malit të Zi. Në këtë telegram ndër të tjera thuhet: *“Për derisa çështja e Shqipërisë së Jugut nuk është rregulluar krejtësisht, nuk më duket me vend, që të futemi në diskutime për një shkëmbim të krahinave midis Malit të Zi dhe Shqipërisë [...]. Eventualiteti i një shkëmbimi i vënë në dukje nga ju, që Gjakova të kalonte me Shqipërisë, do të ishte pa tjetër mjaftë i favorshëm, por nuk e besoj se një shkëmbim i tillë merret seriozisht në kombinacionin e Malit të Zi”*.²³

Është më rendësi të pasqyrohet një urdhër i Ministrisë së Punëve të Jashtme austro-hungareze dërguar Szögyeny-it në Berlin dhe ambasadorit Merey në Romë, lidhur me qëndrimin e qeverisë gjermane dhe italiane, për përcaktimin e kufirit verior. Në këtë urdhër të datës 13 shkurt 1914 ndër të tjera thuhej: *“Ju lutem Shkëlqesisë Suaj, që të parashtroni për diskutim pranë ministrisë së jashtme të atjeshme, çështjen dhe mënyrën e marrjes së vendimeve të Komisionit për Caktimin e Kufirit Verior të Shqipërisë, pasi më duhet që të informohem, në se qeveria perandorake gjermane dhe qeveria mbretërore italiane janë dakord me pikëpamjen e kolonelit Micës, të pranuar nga unë, përpara se t’i dërgoj kabinetit të Londrës përgjigjen përkatëse”*.²⁴ Ambasadori austro-hungarez në Berlin, Szögyeny-i më 19 shkurt e njofton kontin Berhtold se qeveria perandorake gjermane është gjithashtu dakord me pikëpamjen e kolonelit Micel dhe është e gatshme të bashkohet në demarshin që Austro-Hungaria ka vendosur ta bëjë pranë Fuqive të tjera të Mëdha.²⁵

I një rëndësie të veçantë është edhe raporti i datës 28 shkurt 1914 i përfaqësuesit austro-hungarez pranë Komisionit të Kufijve Veriorë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, në të cilin është trajtuar çështja e krijimit të zonave neutrale, që ka qenë kërkesë e Londrës zyrtare dhe çështja e fillimit të punimeve në kufirin lindor afër Prizrenit dhe Dibërës. Në këtë raport, kolonel Micel argumenton arsyet se pse fillimi i punimeve duhej të mbahej në Shkodër, e jo në

²³ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1914)*, 657-658.

²⁴ Po aty, 571.

²⁵ Po aty, 627.

Prizren apo Dibër. Për më tepër në këtë raport thuhej: “*është gjithashtu e sigurtë, se vetëm me anën e verifikimeve në vend, komisioni nuk mund të arrijë në asnjë marrëveshje, në qoftë se nuk vendoset si parim marrja e vendimeve nga shumica... ose në qoftë se nuk arrihet një akord midis Fuqive të Mëdha se teksti përkatës i hartuar në protokollin e Londrës bazohet në kufirin midis krahinës së Lumës dhe të Prizrenit, sipas ndarjes administrative që ekzistonte para 1910-së*”.²⁶

Po ashtu, më 28 shkurt 1914, kolonel Micel i dërgon një informacion kontit Berhtold mbi veprimtarinë dhe dokumentacionin e hartuar nga komisioni, gjatë periudhës së tij të parë. Nga dokumentacioni përfshihej: protokollin mbi seancat dhe bisedimet e delegatëve nga 23 shtatori deri më 13 dhjetor 1913 (3 ekzemplarë) dhe protokollin mbi caktimin definitiv të pjesës së kufirit, që shkon nga Lini deri në Strizak, si dhe gjatë Drinit të Poshtëm, Lokovo deri në Dibër (3 ekzemplarë). Në këtë dokument kolonel Micel e njofton Berhtoldin, se sipas marrëveshjes me delegatin italian, harta definitive e kufirit do të përgatitet në dy pjesë, por në bazë të një çelësi të përbashkët dhe pikërisht, njëra nga deti deri në Drin pranë Prizrenit nga Instituti Gjeografiko-Ushtarak austro-hungarez dhe pjesa tjetër deri në liqenin e Ohrit, nga Instituti Italian në Firenze. Për më tepër, kolonel Micel deklaroi se nga vija e kufirit Lin-Prizren të studiuar nga komisioni, kanë mbetur të hapura akoma dhe çështjet që vijojnë: vija Strizak-Lukovo; vija e kufirit në veri të Dibrës që bën lidhjen midis Drinit dhe vargut të maleve dhe kufiri midis krahinës së Lumës, kazasë së Prizrenit dhe Gorës.²⁷ Vlen të theksohet ditari i vendimeve të Komisionit Ndërkombëtar të Përcaktimit të Kufijve të Shqipërisë Veriore i 5 qershorit 1914, në të cilin janë të përmbledhura të gjitha diskutimet dhe përplasjet e anëtarëve të këtij komisioni në lidhje me vazhdimin dhe përmbylljen e përcaktimit të kufirit.²⁸

²⁶ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1914)*, 712-713.

²⁷ Po aty, 722-723.

²⁸ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1914)*, Vëllimi III, (qershor-korrik), përgatitja dhe redaktimi për botim nga Luan Mallezi, Eriketa Kambo dhe Marenglen Verli, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2019.

Pas shumë peripecish në fakt çështja e përcaktimit të kufijve të Shqipërisë u përmbyll më 1914 me protokollin e Firencës,²⁹ mirëpo me marrëveshjen ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë SKS më 1925, u zgjidh definitivisht çështja kontestuese e Shën Naumit dhe e Vermoshit, e cila shënoi përmbylljen e demarkimit të kufijve verilindorë të Shqipërisë.³⁰ Mbështetur në dokumentet e pasqyruara në këtë punim dhe të arriturat e deritanishme të historiografisë shqiptare dhe të huaj, mund të vijmë në përfundim që Austro-Hungaria, jo vetëm që ka një kontribut të jashtëzakonshëm në krijimin e shtetit shqiptar më 1912, por edhe në përvijimin e kufijve të saj, Vjena zyrtare ka qenë shumë aktive. Austro-Hungaria krahas projektit të saj të paraqitur në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në janar 1913, që ishte në fakt më i favorshmi për shqiptarët, ka dhënë kontribut të madh edhe në Komisionin Ndërkombëtar për Caktimin e Kufijve Verilindorë të Shqipërisë. Anëtari austro-hungarez, kolonel Micel ishte më i zëshmi kur diskutohej për shkëputjen e trevave shqiptare nga Shqipëria politike dhe përfshirjen e tyre në kuadër të Malit të Zi dhe Serbisë.

Pothuajse në të gjitha telegramet, shkresat dhe raportet e konsujve austro-hungarezë dhe të kolonel Micel, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, respektivisht kontit Berhtold është pasqyruar përpjekja e përfaqësuesve austro-hungarezë që përcaktimi i kufijve verilindorë të përmbyllet në favor të Shqipërisë, ngase trevat e

²⁹ Siç u vendos nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër më 1913, kufijtë e Shqipërisë do të vendoseshin nga Komisioni i Caktimit të Kufirit, i cili pasi punoi në terren (në kufijtë jugorë të Shqipërisë) përpiloi protokollin përfundimtar të punimeve të tij në Firence më 17 dhjetor 1913, ndërsa përcaktimi i kufirit në pjesën veriore dhe verilindore mbeti i pazgjidhur për shkak të fillimit të Luftës së Parë Botërore. Kaliopi Naska, *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës*, Trajtesë dhe dokumente, Tiranë: KRISTALINA-KH, 2012, XIV.

³⁰ Për zgjidhjen e çështjes së Shën Naumit dhe Vermoshit shih në: Kaliopi Naska, *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës*, Trajtesë dhe dokumente, Tiranë: KRISTALINA-KH, 2012; Milo, Paskal, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Tiranë: Shtëpia Botuese Enciklopedike, 1991; Skender Lutfiu, *Çështja e shqiptarëve në Jugosllavi në sfondin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë 1918-1939*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021; Hasan Bello, *Bisedimet e Asamblesë Kushtetuese për çështjen e Shën Naumit dhe Vermoshit*, Tiranë: Arbëria, 2006; Myzafer Bislimi & Irjete Ibrahim, “Çështja e Shën Naumit, Dokumente amerikane-raporte të legatës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga Beogradi dhe Tirana lidhur me marrëveshjen shqiptaro-serbe të vitit 1925 për Shën Naum”, *Studime historike*, nr. 1-2 (2012) etj.

pretenduar nga fqinjët e sipërshtënuar ishin të banuara me popullsi shumicë shqiptare. Natyrisht që konsujt austro-hungarezë në raportet dhe telegramet dërguar Vjenës zyrtare kanë pasqyruar edhe vështirësitë klimatike, problemet me forcat serbe që vijonin të ripushtonin trevat shqiptare në veri dhe verilindje të Shqipërisë, pastaj janë pasqyruar ballafaqimet përbrenda Komisionit Ndërkombëtar të Kufirit, ku jo të gjithë përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha mbanin qëndrim të njëjtë me atë të kolonel Micel-it. Madje, siç del nga dokumentet e lartcekura, përfaqësuesi rus dhe ai francez kanë qenë shumë të zëshëm në lidhje me përfshirjen e trevave shqiptare në kufijtë e Malit të Zi dhe të Serbisë.